

17 Dhjetor 2020

## Kumtesë për shtyp

### *U mbajt një konferencë rreth temës për Përmirësimin e Shëndetit Riprodhues*

Në kuadër të projektit CARES, më 16 dhe 17 Dhjetor, u organizua Konferenca për Përmirësimin e Shëndetit Riprodhues me qëllim shkëmbimin e përvojave, mendimeve, modeleve të praktikave më të mira dhe mësimet të marra përsa i përket përmirësimin e shëndetit riprodhues, ngritjen e vetëdijes për këtë temë dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë. Projekti Aktivitetet Ndërkufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues – CARES financohet nga Bashkimi Evropian përmes Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë\*. Autoriteti kontraktues për projektin është Ministria e Financave e Malit të Zi - Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së. Projekti në Kosovë implementohet nga ECMI Kosovo.

Konferenca mbledhi së bashku përfaqësues të institucioneve shëndetësore, organizatave të shoqërisë civile, qeverive shtetërore dhe lokale, medias, partnerë të projektit, etj. nga Kosova dhe vendet e tjera. Në hapjen e Konferencës folën një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë të Malit të Zi, zt. Arben Osmani nga ECMI Kosovo dhe një përfaqësues nga organizata lidere e projektit FORS Montenegro, ndërsa folës në panel diskutimet ishin ekspertë të shquar nga Instituti i Shëndetit Publik të Mali i Zi, Qendra Klinike e Malit të Zi dhe Kosovës dhe institucione të tjera shëndetësore, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile aktive në këtë fushë. Gjatë dy ditëve të kaluara, ata prezantuan të dhëna dhe situatën në lidhje me shëndetin riprodhues në Kosovë dhe rajon, parandalimin, zbulimin dhe trajtimin e kancerit të qafës së mitrës dhe kancerit të gjirit, shembuj të praktikave të mira në këtë fushë, rëndësinë e përfshirjes së të gjitha segmenteve të shoqërisë në ruajtjen e shëndetit, etj.

Aktivitete të tjera të projektit përfshinin prokurimin e pajisjeve për institucionet shëndetësore në rajonin e Dukagjinit në Kosovë me vlerë totale 45,676.90 EUR, organizimin e ekzaminimeve parandaluese gjinekologjike dhe të gjirit për gratë nga komunat e synuara, si dhe një fushatë informuese mbi rëndësinë e parandalimit në shëndeti riprodhues, parandalimi i kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës së mitrës.

Për të gjitha informacionet shtesë, ju lutemi kontaktoni Blerta Visoka, ECMI Kosovo, tel: 038 224 473, e-mail: visoka@ecmikosovo.org.

Ky njoftim është bërë me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e kësaj njoftimi për shtyp është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian



**MNE – KOS**

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020

\* Ky mbishkrim nuk paragjykon statusin e Kosovës dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



Projekt i financuar ng a Bashkimi Evropian



**MNE – KOS**  
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020